



## Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore *Sabit Januzi, Ismet Bahtijari dhe Haxhi Shala*, Kryetarja e Dhomave të Specializuara, më 5 prill caktoi Panelin e Gjykatës Kushtetuese për të vendosur lidhur me Kërkesën Referuese të të akuzuarve me të cilën kundërshtojnë ndryshimet në Rregulloren e Ndhmës Juridike nga Zyra Administrative. Paneli i Gjykatës Kushtetuese përbëhet nga gjykatësit Vidar Stensland, Rumen Nenkov dhe Romina Inkuti.

Më 8 prill, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Sabit Januzit dhe Haxhi Shalës. Ai konstatoi për të dy të akuzuarit se ekziston ende rreziku i arratisjes, pengimit të procesit gjyqësor si dhe rreziku i kryerjes së krimeve të tjera, veçanërisht duke mbajtur parasysh se, me ecurinë e procesit të nxjerrjes së materialeve, të akuzuarit kanë më shumë qasje në informacione të ndjeshme.

Më 8 prill, Kryetare Trendafilova rrëzoi kërkesën e mbrojtjes së Thaçit për të hequr ose zëvendësuar gjykatësin Nikola Giju si Gjykatës të Vetëm. Kërkesa u bë mbi bazën se gjykatësi Giju bëri betimin si gjykatës në GJPN më 8 mars 2024 dhe do të ushtrojë funksionet e tij gjyqësore në GJPN duke filluar nga 19 gushti 2024.

Z. Thaçi argumentoi, ndër të tjera, se pavarësia e gjykatësit Giju cenohet nga fakti që ai përgjigjet para dy gjykatave dhe meqenëse do të përgatitet për të punuar me çështjet që do t'i ngarkohen në GJPN, nuk do të jetë i disponueshëm për të punuar në DHSK.

Kryetarja konstatoi se nuk mund të ushtrojë kompetencën për zëvendësimin e një gjykatësi, përveç nëse gjykatësi nuk është më në gjendje të kryejë detyrat e veta dhe ky nuk është rasti me gjykatësin Giju, sepse ai do të ushtrojë funksionet gjyqësore në GJPN duke filluar nga 19 gushti 2024.

Ajo konstatoi më tej se z. Thaçi nuk ka paraqitur argumente pse është cenuar puna apo pavarësia e gjykatësit Giju si Gjykatës i Vetëm dhe se asnjë gjykatës nuk mund të hiqet mbi bazën e pretendimeve të përgjithshme apo abstrakte që nuk janë as të bazuara dhe as të detajuara. Ajo doli në përfundimin se disponueshmëria e gjykatësit Giju për të ushtruar funksionin si Gjykatës i Vetëm është aspekt që vlerësohet nga Kryetarja dhe është i natyrës administrative dhe jo objekt apelimi prej palëve.

Seanca e radhës në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët* është planifikuar të mbahet më 22 prill, në orën 9 të mëngjesit.

Në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala*, deklaratat përmbyllëse do të mbahen nga data 15-18 prill 2024, ku do të fillojë Prokuroria më 15 dhe 16 prill, e ndjekur nga deklaratat përmbyllëse të Mbrojtësit të Viktimave dhe të





Mbrojtjes. Z. Shala gjithashtu do të bëjë një deklaratë pasi të kenë përfunduar parashtrimet e tyre palët dhe Mbrojtësi i Viktimave.

Pasi Kryegjykatësja ta deklarojë çështjen të mbyllur, gjykatësit e Trupit Gjykues do të kuvendojnë në mënyrë konfidenciale për të dalë me një aktgjykim në lidhje me akuzat në Aktakuzë. Aktgjykimi do të shqiptohet brenda nëntëdhjetë ditësh nga mbyllja e gjykimit, përveç nëse rrethanat kërkojnë më shumë kohë.

### **Pyetje nga gazetarët**

Nuk pati pyetje

